



Data: 07.03.2019

Ref.: 381/19 D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K), Nr.1452/18, datë 31.10.2018, për njohjen e akreditimit të programeve të studimit, si më poshtë:

- Web dhe Informatikë Mobile, BSc, 240 ECTS;
- Informatikë dhe Teknologjitë, BSc, 240 ECTS, dhe
- Teknologji të Ndërtimtarisë, BSc, 240 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K) (tash e tutje RIT Kosovo) ka parashtruar kërkesë (Nr.1452/18, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për njohje të akreditimit të programeve të studimeve si në vijim: Web dhe Informatikë Mobile, BSc, 240 ECTS; Informatikë dhe Teknologjitë, BSc, 240 ECTS; Teknologji të Ndërtimtarisë, BSc, 240 ECTS; Studime Profesionale, MSc, 60 ECTS, dhe Artet dhe Shkencat e Aplikuara, BSc, 240 ECTS. Këto programe janë të akredituara nga Agjencia e Akreditimit "CHEA" në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Institutin e Teknologjisë në Roçester (Rochester Institute of Technology, RIT).

Bazuar në nenin 10 dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e RIT Kosovo, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar duke iu referuar pikës 1.2 të këtij neni, ku thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike

se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”,

Sipas pikës një te nenit 23 të UA për Akreditim, *“Çdo institucion mund të propozojë të ofrojë në Kosovë program të studimit të cilat shpijnë në marrjen e një grade akademike apo diplome të huaj, më kushte që këto programe të studimit të institucionit të huaj të arsimit të lartë të jenë të akredituara nga një agjenci e njohur e sigurimit të cilësisë nga ENQA, EQAR dhe CHEA”. Ndërsa sipas pikës dy të këtij neni, “Te gjitha këto propozime duhet të aprovohen nga AKA”.*

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

1. Për programin e studimit: *Web dhe Informatikë Mobile, BSc, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi RIT Kosovo ka paraparë këta persona: Erik Golen, Tae Oh, Nirmala Shoney, dhe Kristen Shinohara.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Sipas pikës një (1) të nenit 30 të UA për Akreditim: *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor”.* Ndërsa sipas pikës 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.*

Mbi këtë bazë, dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga RIT Kosovo, u konstatua që asnjëri nga bartësit nuk i përmbush kriteret ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit, pasi që asnjëri nga ta nuk është deklaruar sipas afateve të përcaktuara me nenin 30 të cekur me lartë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzoj njohjen e akreditimit për këtë program të studimit, *Web dhe Informatikë Mobile, BSc, 240 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Informatikë dhe Teknologjitë, BSc, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi RIT Kosovo ka paraparë këta persona: Brian Toaszewski, Ronald Vullo, Qi Yu, dhe Charlie Border.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Sipas pikës një (1) të nenit 30 të UA për Akreditim: *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor”.* Ndërsa sipas pikës 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do te konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.*

Mbi këtë bazë, dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga RIT Kosovo, u konstatua që asnjëri nga bartësit nuk i përmbush kriteret ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit, pasi që asnjëri nga ta nuk është deklaruar sipas afateve të përcaktuara me nenin 30 të cekur me lartë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzoj njohjen e akreditimit për këtë program të studimit, *Informatikë dhe Teknologjitë, BSc, 240 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Teknologji të Ndërtimtarisë, BSc, 240 ECTS*, si bartës të këtij programi RIT Kosovo ka paraparë këtë persona: Kamal Shahrabi.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Ky program i studimit ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, IAL-ja duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën shkencore PhD nga fusha e programit të studimit në marrëdhënie të rregullt të punës. Ndërsa RIT Kosovo ka vendosur vetëm një staf (Kamal Shahrabi) akademik për këtë program të studimit. Mbi këtë bazë, ne mungesë të stafit akademik, dhe faktin që stafi nuk ka deklaruar angazhimin e vet si staf akademik në afatin e paraparë me nenin 30 të UA për Akreditim, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sipas pikës një (1) të nenit 30 të UA për Akreditim: *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo me larg se data 31 tetor”.* Ndërsa sipas pikës 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, *“Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do te konsiderohet në*

procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.


Mbi këtë bazë, dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga RIT Kosovo, u konstatua se bartësi i propozuar nuk i përmbush kriteret ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit, pasi që nuk është deklaruar sipas afateve të përcaktuara me nenin 30 të cekur më lartë.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë njohjen e akreditimit për këtë program të studimit, *Teknologji të Ndërtimitarisë, BSc, 240 ECTS.*

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditës nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K);
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

